



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 016
Prishtinë, më 18 e 21 prill 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
18 e 21 PRILL 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 108 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i vazhdoi punimet me këtë

R e n d i i d i t ë s:

1. Fjala e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me gjendjen e përgjithshme në vend,
2. Informata për punën 100 ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
3. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008-2011.

1. Fjala e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me gjendjen e përgjithshme në vend

Kryetari e ftoi Presidentin e Republikës së Kosovës që t'iu drejtohet deputetëve.

Presidenti i Republikës së Kosovës, **Fatmir Sejdiu**, në fillim të fjalimit, përshëndeti deputetët e Kuvendit, anëtarët e Kabinetit qeveritar, përfaqësuesit e Misionit Civil Ndërkombëtar, të UNMIK-ut dhe të misioneve diplomatike.

Presidenti në fjalimin për gjendjen e përgjithshme në vend dhe për synimet strategjike të vendit theksoi se data e 17 shkurtit të vitit 2008 do të hyjë në historinë e Kosovës e të botës si Dita e Pavarësisë së vendit tonë. Dy muaj më pas miratuam Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pavarësia jonë është njohur nga 37 vende, duke përfshirë edhe 7 nga 8 vendet e G 8-shit. Vendi ynë pret njohje nga shumë vende të tjera. Kjo siguron bazën e rëndësishme për të mbështetur inkuadrimin tonë në sistemin ndërkombëtar. Integrimi ynë në strukturat Euroatlantike është prioritet mbi të gjithë të tjerët.

Me dekada, breza të tërë veprimtarësh shqiptarë punuan për ta zgjidhur çështjen e Kosovës. Ishin këto përkushtime e sakrifica të pandërprera dhe më sublimë të mundshme. Personalitete të shumta, përgjatë dekadave u pushkatuan apo vuajtën në burgje të rënda dhe afatgjata.

Ideja e shtetit të pavarur të Kosovës ka lindur, është kultivuar dhe është ndërtuar gjatë rezistencës së përgjithshme politike e institucionale të udhëhequr nga Presidenti Ibrahim Rugova në dekadën e fundit të shekullit të kaluar. Komplementare me këtë ide, pjesë e saj dhe e luftës politike, ka qenë lufta e armatosur e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në fund të shekullit, që lidhet me komandantin Adem Jashari dhe me shumë luftëtarë të lirisë anekënd Kosovës.

Shfrytëzojmë rastin që në emrin e shtetit të Kosovës t'u shprehim mirënjohjen më të thellë të gjithë atyre që derdhën gjak, djersë dhe dije për pavarësinë e Kosovës.

Tash, që jemi shtet i pavarur dhe sovran, kemi mundësinë ta drejtojmë Kosovën në rrugën e zhvillimit strategjik.

Pasuritë natyrore dhe popullsia e re - janë potenciale të zhvillimit të Kosovës në afat të gjatë. Zhvillimi i plotë i tyre bëhet i mundshëm tash që kemi një Qeveri sovranë, jo të përkohshme.

Rimëkëmbja e plotë, rilindja e vërtetë e Kosovës mundet dhe duhet të ndodhë duke vënë në lëvizje potencialet njerëzore, duke ndërtuar institucione demokratike e plotësisht funksionale, duke ndërtuar ekonomi dhe rrjet arsimor e shëndetësor të qëndrueshëm.

Fushat strategjike ekonomike që kërkojnë vëmendjen dhe përkushtimin prioritar të shtetit tonë janë energjetika dhe agrikultura.

Regjistrimi i pritshëm i popullsisë dhe i ekonomive familjare të Kosovës do të sigurojë pasqyrë të plotë statistikore, kuantitative dhe kualitative për drejtimet strategjike që duhet të marrë zhvillimi i Republikës së Kosovës.

Duke pasur një popullsi të re, rimëkëmbja e sistemit arsimor bëhet për ne çështje me rëndësi thelbësore, që prek indin më të shëndoshë të qenies sonë.

Punonjësit e arsimit dhe të shëndetësisë të Kosovës duhet të nxirren prej kategorisë së shërbyesve civilë, ku bien aktualisht, për të krijuar mundësinë e diversifikimit dhe të konkurrencës së shërbimeve në rrethana të ekonomisë së tregut.

Është koha që të vihet rend në arsimin e lartë, duke aplikuar kritere të pranuar ndërkombëtare për akreditimin e institucioneve. Universitetet nuk guxojnë të shndërrohen në biznese fitimprurëse. Ato duhet të gjenerojnë dije, jo para.

Kushtetuta jonë siguron ndarjen dhe baraspeshimin e kontrolluar të të tri pushteteve: të legjislativit, të ekzekutivit dhe të gjyqësori për të krijuar një pushtet koheziv e demokratik.

Si President i vendit do të jem në shërbim të unitetit demokratik të popullit dhe të Republikës së Kosovës.

Në fushën e politikës së jashtme të vendit, prioritet të parë do ta kemi sigurimin e njohjes sa më të shpejtë dhe integrimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare.

Do të krijojmë përfaqësim diplomatik në botë në përputhje me mundësitë dhe interesat jetike të Republikës së re të Kosovës. Do të ndërtojmë edhe shërbimin konsullor jashtë, për t'u shërbyer qytetarëve të huaj dhe diasporës sonë.

Forca e Sigurisë së Kosovës do të ndërtohet mbi kriteret e NATO-s dhe me ndihmën e Aleancës. Do të forcohet Policia e Kosovës për të marrë detyra të reja. Do të krijohet Agjencia e Inteligjencës e Kosovës mbi kritere profesionale, e paanshme politikisht, besnike ndaj shtetit dhe interesave të të gjithë qytetarëve tanë.

Gjyqësori i Kosovës është pushtet që pret të reformohet thellësisht në pajtim me nevojat e vendit tonë dhe standardet e fuqishme ndërkombëtare që i kemi përqafuar për këtë fushë.

Unë, si President, do të luaj rolin që më takon për të siguruar bazat e kësaj reforme, për të krijuar një gjyqësor të pavarur, shtyllë të rëndësishme të shtetit ku sundon ligji, me barazi të të gjithëve para këtij ligji.

Pavarësia jonë, e mbikëqyrur në këtë periudhë, mbështetet mbi premisën e një komponente të fuqishme të pranisë ndërkombëtare - Misionit të EULEX-it, të udhëhequr nga Bashkimi Evropian, që do të ketë rol më shumë se mbikëqyrës në fusha të sigurisë dhe të ligjit.

Republika e Kosovës është atdheu ynë: i të gjithëve pa dallim. Kosova ka bërë vendin e vet në hartën politike të botës dhe do të rrethohet me fqinjë miqësorë. Ne duam të kultivojmë marrëdhënie të mira e miqësore me të gjitha vendet, në radhë të parë me fqinjët tanë të parë: me Maqedoninë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë, me vendet e rajonit dhe të Evropës.

Këto ditë ekziston një fushatë e madhe dhe përpjekje e Serbisë për mbajtje të zgjedhjeve që ka paralajmëruar për 11 maj.

Kosova nuk është dhe nuk mund të jetë bazë zgjedhore për krijimin e pushtetit të Serbisë në Kosovë. Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, i njohur ndërkombëtarisht. Me parimin e dyshetësisë, serbët e Kosovës që duan të jenë edhe shtetas të Serbisë, mund të votojnë për pushtetin e Serbisë në Serbi. Prandaj, i thërrasim që të jenë akterë të rëndësishëm të ndërtimit të institucioneve të Kosovës dhe jetës së përbashkët.

2. Informata për punën 100 ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi Kryeministrin e Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë Informatën për punën 100 - ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, **Hashim Thaçi**, tha se me vullnetin e tij dhe të të gjithë ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, paraqet informatën e plotë për punën e Qeverisë në 100 ditshin e parë.

Gjatë kësaj kohe ne bashkërisht, të gjitha institucionet, Kosovën e bëmë shtet të pavarur, sovran dhe demokratik, të cilin gjatë kësaj periudhe e njohën rreth 40 shtete më të fuqishme të botës demokratike dhe procesi i njohjes është në vazhdim.

Në këtë kohë Kosova nxori edhe Kushtetutën e shtetit të vet, që i hap perspektivë të sigurt edhe zhvillimit ekonomik, stabilitetit institucional, sundimit të ligjit dhe perspektivës integruese.

Kemi filluar implementimin e premtimeve tona, të dhëna më herët, me përgjegjësi të lartë shtetërore. Kemi filluar së instaluari qeverisjen e mirë, stabile, efikase dhe shumë transparente. Kemi filluar implementimin e procesit të zhvillimit të arsimit.

Kemi filluar që t'i nxjerrim nxënësit nga konteinerët, të bëjmë zgjerimin dhe modernizimin e hapësirave edukative, të ndërtojmë shkolla të reja dhe t'i kompjuterizojmë ato. Kemi krijuar autonomi menaxheriale dhe financiare për Universitetin e Prishtinës.

Kemi marrë masa si Qeveri për llogaridhënie për shpenzimet e parasë publike. Vetëm me vendim për kufizimin e shpenzimeve brenda Qeverisë, jemi zotuar që t'i kursejmë së paku 30 milion euro.

Kemi vazhduar me infrastrukturë rrugore, ndërtimin e shumë rrugëve lokale dhe fillimin e angazhimeve konkrete për ndërtimin e auto-rrugëve nacionale. Është hapur oferta për fillimin e punimeve të auto-rrugës Vërmicë – Prishtinë - Merdar. Në anën tjetër, ka filluar studimi për Auto-rrugën Prishtinë - Ferizaj - Hani i Elezit.

Gjendjen energjetike e kemi gjetur në kolaps të vërtetë, në një anarki të vërtetë, në një krizë të vërtetë. Kemi ndërtuar strategjinë konkrete, e cila është përgatitur nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. Kjo strategji vazhdon me objektivat për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike, duke u përmbajtur në mënyrë të plotë kriteret për mbrojtjen e ambientit jetësor. Gjithashtu, është formësuar edhe vendimi për kompletimin e Komitetit Drejtues për projektin e Kosovës C.

Gjithashtu, kemi nxjerrë strategjinë për ngritjen e kapaciteteve alternative për prodhimin e energjisë natyrore, të hidrocentraleve dhe të centraleve të erës.

Kemi filluar të bëjmë Qeverinë transparente që nga dita e parë për qytetarët tanë të cilëve edhe u shërbejmë.

Pensionistët veç kanë prekur rezultatin e parë të premtimeve dhe të përgjegjësi e të vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kemi filluar sigurimin e barërave esenciale falas, të transporti publik 50% më të lirë, fillimi i ngritjes pothuaj 100% i pensioneve për pensionistët kontribut-dhënës. Ligji për pensionistët është në fazën finale dhe do të nxjirret së shpejti e do të fillojë së implementuari.

Shëndeti i qytetarëve tanë vazhdon të jetë shqetësim për Qeverinë. Jemi angazhuar që gjendja në sektorin e shëndetësisë të përmirësohet, të depolitizohet dhe të dekriminalizohet, të tejkalohen fenomenet negative, të ketë higjienë të standardit më të lartë, barëra më shumë dhe më cilësore, infrastrukturë më moderne, investim në dije, përgatitje që të jemi edhe pjesë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ne e vlerësojmë punën e gjithë atyre njerëzve vullnetmirë, të njerëzve profesionistë në sektorin e shëndetësisë.

Kemi vazhduar me reforma në drejtësi për gjyqësi të pavarur funksionale, sundim të ligjit në tërë territorin e Kosovës. Do t'i vazhdojmë reformat në ekonomi dhe financa , por, gjithashtu, edhe në rritje të angazhimeve në tregti dhe industri dhe në vazhdimin e reformimit të pushtit lokal për të cilën kemi vendosur bashkërisht të gjithë sipas standardeve dhe Dokumentit të Presidentit Ahtisari.

Gjithashtu, janë rritur përkushtimet edhe investimet për rininë, sportin dhe çështjet jorezidente.

Kosova në këtë periudhë ka filluar t'i ndërtojë të gjitha institucionet funksionale shtetërore. Është i nominuar ministri për Punë të Jashtme. Në ditët e ardhshme do të formohen edhe Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Inteligjent i Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, është rritur përkushtimi dhe investimi në: bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor.

Është bërë një punë shumë e mirë prej ministrit për Kthim në çështjet e kthimit të të zhvendosurve që Kosova definitivisht të vazhdojë të ndërtojë realitetin se Kosova është atdhe i të gjithë qytetarëve, Kosova është vend demokratik.

Unë, me përkushtimin më të lartë, moral, kombëtar dhe shtetëror do të vazhdoj të punoj sa më shumë dhe sa më mirë që të mundem në shërbim tuaj dhe të vendit tonë në përmbushjen e qëllimit tonë për të ndërtuar një Kosovë edhe më të mirë, më të zhvilluar dhe më të fuqishme - Republikën tonë të re.

Kryetari, në emër të deputetëve të Kuvendit e falënderoi Kryeministrin e Kosovës për informatën e prezantuar.

3. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008-2011

Kryetari e ftoi Kryeministrin e Republikës së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë Programin e Qeverisë.

Kryeministri Hashim Thaçi tha se Programi qeveritar paraqet bazat për Kosovën shtet të qytetarëve, të zhvilluar në përputhje me parimet demokratike, të një ekonomie të lirë dhe të qëndrueshme, të një mjedisi shumetnikë dhe të përkushtuar qartë në drejtim të proceseve euro-atlantike.

Me këtë Program, prioritetet më të shprehura janë në katër shtylla kryesore: **rritja ekonomike, implementimi i statusit, qeverisja e mirë, zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social.**

Këto prioritate përcaktojnë seriozitetin tonë për të filluar me çështje konkrete dhe sfiduese për zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës.

1. Zhvillimi ekonomik do të realizohet përmes intensifikimit të investimeve, privatizimit dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve publike, shtimit të aftësisë konkurruese dhe rritjes së eksportit.

Ky Program ofron mundësinë dhe krijimin e një ambienti të përshtatshëm për tërheqjen e investimeve të huaja dhe që të jemi konkurrues në vendet e regjionit. Investimet kualitative me qëllim të rritjes së produktivitetit, në veçanti në sektorin e energjetikës dhe në infrastrukturën rrugore.

Sektori i bujqësisë ka vëmendje të veçantë në këtë program dhe do të mundësojë rivitalizimin e tij dhe ndikimin direkt në uljen e pa punësisë.

Energjia dhe minierat, furnizimi cilësor dhe i qëndrueshëm janë parakusht të zhvillimit të gjithmbarshëm të Kosovës.

Me planin afatgjatë, synimi i Qeverisë është procesi i ndërtimit të Termocentralit C.

Për prodhimin e energjisë elektrike, përveç formave që e kanë për bazë linjitin, do të hulumtohen potenciale tjera të energjisë, sikur janë hidrocentralet në Zhur apo në vende të tjera, por edhe centralet me erë.

Investimet në sektorin e transportit do të jenë të orientuara në ndërtimin e autostradave, të rrugëve të reja, në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugëve ekzistuese, rregullimin e kadastrit të rrugëve, si dhe rritjen e sigurisë në komunikacion.

Sektori i telekomunikacionit do të reformohet me legjislacion dhe teknologji. Do të konsolidohet Operatori Publik i Telefonisë, do të rritet, zgjerohet dhe përmirësohet Shërbimi Telefonik Postar dhe ai i Internetit përmes formave të veçanta ose të kombinuara të financimit publik dhe të atij privat.

Në këtë program, si prioritet i Qeverisë, prej më të rëndësishmëve, është **arsimi**. Programi për arsim bazohet në dije, ekonomi dhe punësim. Këtu përfshihet cilësia në arsim, qeverisja më cilësore, lidhjet e arsimit dhe të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, avancimi i gjendjes materiale dhe ngritja e kapaciteteve për punë kërkimore dhe shkencore.

Politika tatimore do të shqyrtohet me qëllim të përmirësimit të shkallës konkurruese në raport me vendet e regjionit. Norma tatimore do të jetë stimuluese për biznesin dhe do të shqyrtohen problemet administrative të identifikuara.

Në sektorin financiar do të angazhohemi për zvogëlimin e interesave që janë relativisht të larta dhe jo shumë stimuluese për investime.

2. Implementimi i statusit, shteti funksional dhe demokratik dhe implementimi i plotë i marrëveshjes së statusit do të jetë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Në këtë drejtim do të krijojmë misione diplomatike në botë, ambasada, por edhe forcën e sigurisë, si njësi profesionale.

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës është e përfshirë në këtë program, duke paraparë përshpejtimin e procesit të njohjes së shtetit të Kosovës, thellimin e marrëdhënieve të veçanta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet e Bashkimit Evropian, shtetet fqinje, ndërtimin e shërbimit diplomatik dhe konsullor të Kosovës, anëtarësimin e plotë të vendit tonë në organizatat dhe institucionet kryesore, politike, ekonomike dhe financiare ndërkombëtare, mbrojtjen e interesave të qytetarëve tanë në botën e jashtme, si dhe afirmimin e identitetit të Kosovës në botën e jashtme.

3. Qeverisja e mirë është një nga preokupimet dhe zotimet e Qeverisë sonë. Tani më vlerësimet e para veç i kemi nga të gjithë. Përcaktimi i qartë i kompetencave dhe i përgjegjësi në të gjitha fushat dhe veprimtaritë, shërbimet e mira dhe transparente, llogaridhënia për shpenzimet e parasë publike, reforma në administratën publike dhe veprimet e tjera që sigurojnë qeverisje të mirë, janë pjesë e këtij programi dhe zotim i imi dhe i të gjithë ministrave.

4. Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social. Ndhima sociale për familjet e varfra është qëllim kryesor që bëhet nga një sistem i mbrojtjes sociale për personat që nuk mundën t'i ndihmojnë vetvetes e familjes, që Qeveria t'ju ndihmojë me garantimin e të ardhurave minimale për jetesë me dinjitet. Këtu përfshihet edhe kujdesi shëndetësor dhe shkollimi i fëmijëve që jetojnë në varfëri.

Për individët dhe grupet me nevoja urgjente, ky Program ofron përkujdesjen e nevojshme, duke respektuar, përmbushur dhe mbrojtur të drejtat e tyre.

Krijimi i sistemit të qëndrueshëm për sektorin shëndetësor dhe mundësia e përmirësimit të gjendjes shëndetësore të popullatës, janë pjesë e këtij programi.

Aplikimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore dhe përshtatja e tij me mundësitë reale të implementimit janë pjesë e qëndrueshme të Programit.

Kryetari hapi debatin për Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008 – 2011.

Në fillim, diskutuan kryetarët e grupeve parlamentare.

Ramë Buja, në emër të i Grupit Parlamentar të PDK-së tha se Programi, të cilin e ka ofruar Qeveria, është program i perspektivës së Republikës së Kosovës. Programi i Qeverisë parasheh një zhvillim të gjithanshëm, si në sektorin ekonomik, social, infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi. Qeveria, me angazhimin e saj të deritanishëm premtan se do ta realizojë programin e saj.

Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah Programin e Qeverisë për periudhën 2008 – 2011 dhe do t'i japë mbështetje Qeverisë për realizimin e këtij programi.

Lutfi Haziri, në emër të i Grupit Parlamentar të LDK-së tha se e mbështet Programin e Qeverisë, të paraqitur sot nga Kryeministri Thaçi. Mbështetja jonë bazohet në angazhimin tonë duke qenë partneri kryesor i qeverisjes. Ministrat nga radhët e LDK-së në Kabinet kanë marrë pjesë aktive në hartimin e këtij programi. Ky Program është i

mirë për të ardhmen e Kosovës, ka politikat e qarta sektoriale, të ndërtuara me afate kohore, me programe ditore, javore dhe periodike.
Deputetët nga radhët e LDK-së, përveç mbështetjes që do t'i japin programit, do ta pasurojnë atë me diskutimet e veta. Ata janë ftuar sot që të jenë pjesë konstruktive të këtij debati.

Ibrahim Gashi, në emër të i Grupit Parlamentar të AKR-së tha se problemi kryesor i Programit të Qeverisë është qasja e tij, janë më tepër qëllime që mund të formulohen lehtë në letër, por është mungesa kryesore e ofrimit të mekanizmave për zbatimin e tij.

Programit i mungon konsistenca dhe ka diskrepancë të vazhdueshme.
Tek zhvillimi ekonomik, shtetet kanë 2 -3 instrumente për të infuzionuar ekonominë, politikën fiskale, politikën monetare, huat, por mund të jetë edhe investimi në kapitalin social.

Zvogëlimi i tatimeve përmes tërheqjes së investimeve të huaja, nuk të jep siguri të mjaftueshme se kjo do të funksionojë.
Programi nuk ofron asnjë instrument mbrojtës nga rastet emergjente, tërmetet, fatkeqësitë elementare.
Për papunësinë nuk paraqitet asnjë instrument që garanton zvogëlimin e saj, qoftë edhe 1% .
Bujqësia dhe zhvillimi rural: I njëjti sindrom, thuhet se do të zhvillohet bujqësia, do të bëhet kjo apo ajo, por nuk tregohet si dhe kur.

Pensionet: Nuk është shumë kredibile ajo çfarë thuhet, nuk ka diçka të re përpos asaj që ka qenë edhe nga politika e kaluar.

Implementimi i Statusit: Kjo është pjesa ku në fakt të gjithë, edhe njerëzit nga opozita, edhe nga pozita kanë dhënë vlerësime pozitive për punën e Qeverisë. Mirëpo, në krejt këtë e ka pasur aleatë të fortë për ta kryer këtë punë edhe opozitën, edhe faktorin ndërkombëtar.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se Programi i Qeverisë nuk e përmban as edhe një datë të vetme, përpos datës 17 shkurt, që tregon se kur fillon dhe kur përfundon ndonjë program i caktuar.

Qeveria, as pas 100 ditëve të punës, nuk ka mbërri të nxjerrë diçka të qartë në letër edhe të vijë e të na tregojë, kështu duam të bëjmë. Fjalitë kryesore të cilat gjenden në këtë program janë: do të provojmë, do të tentojmë t'i gjejmë mënyrat, etj.
Për pensionet në Programin e Qeverisë ka vetëm tre reshta.
Për rritjen e kapacitetit fiskal të komunave në Programin e Qeverisë thuhet se ato duhet të krijojnë kushte për rritjen e shkallës së pavarësimit buxhetor, duke zgjeruar gamën e të hyrave vetanake dhe duke ngritur shkallën e inkasimit.

Përpos Programit, edhe strategjia legjislative, të cilën e kemi marrë më herët, shihet se kjo Qeveri nuk ka asnjë sens më të voglin të qeverisjes. Ajo nuk është strategji, është listë e ligjeve, të cilën e ka hartuar Qeveria e mëparshme.

Një pjesë tjetër e dështimit të kësaj Qeverie është Mitrovica. Qeveria ka dështuar të japë edhe idenë më të vogël se qysh do ta zgjidh problemin e Mitrovicës.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së tha se ky dokument mund të jetë gjithçka tjetër, vetëm program jo! Mund të jetë koncept, vizion, analizë, gjithçka, por nuk i ngjason një Programi qeveritar.

Qeveria i adreson, përmes këtij dokumenti, katër prioritete, si: rritja ekonomike, implementimi i statusit, qeverisja e mirë, zbutja e papunësisë, e varfërisë dhe stabilitetit social. Kjo qasje është krejt e mbrapshtë. Siç po shihet, paska qenë kapaciteti shumë i kufizuar i atyre, që e kanë formuluar këtë dokument.

Degët kryesore të ekonomisë, për të cilat është pretenduar se janë bazë për ecje të sigurt përpara, që e çojnë këtë vend drejt një krijimi të stabilitetit, sipas këtij dokumenti, asgjë konkrete nuk ka.

Përmenden investimet e huaja, por Qeveria s'i tregon se cilat veprime do t'i ndërmarrë për t'i joshë ato investime.

Nuk përmendet asnjë hap konkret se cila do të ishte rruga konkrete në zbutjen, të paktën daljen nga kjo krizë e thellë që e ka kapluar sistemin shëndetësor të vendit.

Përveç disa iniciativave konkrete, që ka ndërmarrë nga kjo Qeveri, në këtë dokument nuk figuron asgjë.

Zylfi Merxha, ë emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha se kjo Qeveri për 100 ditë ka bërë shumë punë të mëdha. Por, ajo nuk e ka shkopin magjik që problemet e grumbulluara më herët t'i zgjidhë për një kohë kaq të shkurtër.

Merita e kësaj Qeverie, të udhëhequr nga kryeministri Thaçi, është pavarësia e Republikës së Kosovës. Pas shpalljes së pavarësisë i gjithë opinioni ndërkombëtarë është kthyer kah Kosova dhe ka shprehur simpati ndaj saj.

Kjo Qeveri do ta udhëheq Kosovën në rrugë të mbarë, të cilës shumë vende do t'ia kenë lakmi.

Branislav Grbiq, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, tha se Programi i çdo Qeveri vlerësohet në atë masë sa ai është i zbatueshëm dhe i pranueshëm nga qytetarët e saj.

Opozita ndaj Programit qeveritar shërben si inkurajim për Qeverinë që të jetë më e fortë dhe të këmbëngul në realizimin e objektivave, që i ka parashikuar në programin e saj.

Njëri nga problemet me të cilin duhet të merret kjo Qeveri, është edhe veriu i Mitrovicës. Atje problemet ka kohë që janë grumbulluar, të cilat kjo qeveri duhet t'i zgjidhë. Për zgjidhjen e tyre duhet të krijohet një besim dhe jetë të përbashkët për të gjitha komunitetet në Kosovë. Qeveria do të jetë e suksesshme nëse këtë problem e zgjidh, për të cilën duhet shumë besim, për kohën që po vjen.

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së e falënderoj Kryeministrin për paraqitjen e Programit, të cilin e mbështesim dhe do të angazhohemi që ai të implementohet.

Debati me deputetët, sipas radhës së paraqitjes, vazhdoi gjatë ditës së premte më 18 dhe të hënën, më 21 prill 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008 – 2011 dhanë edhe këta deputetë: **Slavisha Pektoviq, Bahri Hyseni, Donika Kadaj, Fatmir Rexhepi, Melihate Tërmkolli, Safete Hadërgjonaj, Naim Maloku, Sanije Aliaj, Numan Baliq, Haki Shatri, Rasim Selmanaj, Memli Krasniqi, Synavere Rysha, Xhezair Murati, Vlora Çitaku, Gjylnaze Sylja, Xhevdet Neziraj, Berat Luzha, Fehmi Mujota, Besa Gaxheri, Nait Hasani, Bajram Kosumi, Gani Koci, E'them Çeku, Driton Tali, Gani Geci, Gani Buçinca, Sabri Hamiti, Zafir Berisha, Dritë Maliqi, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Naser Rugova, Zylfije Hundozi, Hajredin Hyseni, Adem Salihaj, Kaqusha Jashari, Myrvete Pantina, Esat Brajshori, Drita Kadriu, Riza Smaka, Berim Ramosaj, Myzejeme Selmani, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Rita Hajzeraj, Qamile Morina, Agim Velu, Arsim Rexhepi, Bujar Bukoshi, Suzanë Novobërdaliu, Naim Rrustemi, Hajdin Abazi, Eset Cakolli, Sala Berisha- Shala, Shkumbin Demaliaj, Nyrishahe Hulaj, Mimoza Ahmeti, si dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, ministrat Ahmet Shala, Lutfi Zharku dhe Alush Gashi, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.**

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari mbylli debatin dyditor për Programin e Qeverisë së Kosovës në orën 19:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale